



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



**Kuvendi i Komunës Klinë**  
**Komiteti për Politikë dhe Financa**  
01Nr 06 - 18538 /24  
Klinë, dt: 07-06 /24

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 20.05.2024, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z.Fadil Gashi, i cili përshtëndeti të gjithë anëtarët e komitetit, drejtorë të drejtorive dhe gjithë të pranishmit.

### RENDI I DITËS:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2023, dhe bartjen në vitin 2024 (Ref.drejt.fin);
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale (Ref.drejt.fin).

**Fadil Gashi, kryesues:** Ne jemi prezentë gjashtë anëtarë, Valmira Krasniqi ka konfirmuar që është jashtë vendit dhe nuk mund të marr pjesë. Ne mund të procedojmë, kemi kërkesë për ta

mbajtur këtë takim dhe ju e dini se në takimet e jashtëzakonshme caktohen pikat prej propozuesit. A po pajtoheni me rendin e ditës, kush është për?

**Me 6 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Te shqyrtimi i mungesave sapo e konfirmova për Valmira Krasniqin që nuk mund të merr pjesë.

**Pika 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2023, dhe bartjen në vitin 2024 (Ref.drejt.fin).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Drejtori ndoshta na sqaron, urdhëro, drejtor!

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, kryesues, përshtendetje për anëtarët e KPF-së, drejtorin e Administratës, z. Binak Sylën dhe gjithë të pranishmit! Ashtu qysh jemi dekluaruar vitin e kaluar, në fund të vitit kalendarik, se të hyrat vetanake kanë pasur një rritje bukur të madhe në inkasimin e mjeteve dhe faktikisht falë asaj arritje, falë atij buxheti që është krijuar, ne tash kemi paraparë që para jush ta prezantojmë këtë rritje dhe ta bëjmë alokimin e mjeteve nëpër programe të caktuara.

Dmth rritja për vitin 2023 e që kalon në vitin 2024, 423,969.16 euro, dmth kjo është mbi planifikimin buxhetor që është bërë për vitin 2023 dhe duke i parë kërkesën edhe nevojat që i ka komuna, ne kemi bërë edhe ndarjen e këtij buxheti në mallra dhe shërbime kemi planifikuar me i pas shtesë 65,000.00 euro; duke e ditur se janë rritur nevojat për shërbime dhe për mallra, në kategorinë e dytë janë shpenzime komunale për 20,000.00 euro; edhe këtu duke e pasur parasysh që tarifat janë rritur në ambient, edhe në pompa termike disa investime që janë bërë, ndërsa në shpenzime kapitale është pjesa më e madhe që janë bërë, që janë 338,969.00 euro. Nuk e di a e keni marr materialin ju me kohë apo jo, por nëse e vlerësoni se me specifikuar secilën bartje ku është bërë, se për shkak të ndryshimit të kodit që është bërë, nuk quhet më *bartje* por është *rritje*, a në fakt kjo është bartje, se deri në këtë vit ka qenë bartje; tash e tutje është rritje e këto mjete janë të dedikuara ashtu qysh e thash në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Mjetet janë diku 65,000.00 euro, në këtë kategori ekonomike mallra dhe shërbime në shumën prej 65,000.00 euro dhe përdoren për mirëmbajtjen e rrugëve lokale; në kategorinë e shpenzimeve komunale janë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa i ka 10,000.00 euro. Për shkak të mbulesave që është rrit tarifa e mbeturinave dhe administrata i ka po ashtu 10,000.00 euro, mjete që duhet përdorur për nevoja

të Drejtorisë së Administratës. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale dmth i keni projektet që i keni parë besoj me emër e me mbiemër, te investimet se kah kanë me shkuar, nëse ka nevojë me përmend secili veç e veç ne mund ta përmendim, por nëse ju e vlerësoni që keni të dhëna dhe e dini kah kanë shkuar këto mjete nuk isha lëshuar dmth më shumë. Përveç që te shërbimet rezidenciale që fjala është për ndërtimin e shtëpisë së pleqve, duke ju ndarë 100,000.00 euro, sepse ajo është po thua jse në fazën e mesme të ndërtimit, po realisht ka nevojë për mjete shtesë për shkak se nuk e kemi pas krejt buxhetin, është projekt shumëvjeçar derisa të realizohet, kështu që, prej kësaj mbetje ose prej kësaj bartje të mjeteve ne kemi planifikuar që për këtë projekt t'i qojmë nga 100,000.00 euro. Nëse dikush ka diçka më tepër për sqarime, le të urdhërojë!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor! Po, urdhëro, Tunë Deda?

**Tunë Deda:** Përshëndetje, kryesues, për ju, përshëndetje për dy drejtorët që jeni këtu dhe gjithë të pranishmit! Së pari dua të ju përgëzoj dhe falënderoj edhe juve si drejtor, edhe ekzekutivin edhe qytetarët, se ata janë që kanë bërë pagesën dhe tatimet dhe e kanë rrit buxhetin, sepse janë vetëdijesuar dhe e kanë parë që po ju kthehen mjetet e tyre në punë. Por e kam një kërkësë, që është dashur me paraparë, pasi fabrika e ujit është në ndërtim e sipër edhe një impiant i ujërave qenka i paraparë në Radulloc, po do të ishte mirë me qenë edhe në Krushevë, për arsy që pastrohet lumi edhe atëherë ka me qenë uji shumë më i pijshëm në këtë drejtim. Është dashur me lënë një impiant që është i paraparë diku tjeter, prapë po e them vetëm për hir të qytetarëve që të ju sigurohet ujit e pjes, është dashur me paraparë edhe në Krushevë të vogël.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Tunë! Shikoni, ne e kemi nxjerr një vendim në seancën e dytë, drejtori na ndihmon këtu, është i njëjtë vendim po tash ka me ndryshime, po të njëjtat shuma janë. Nëse se kam gabim, unë e kam vendimin që e kemi nxjerr në kuvend, na u ka kthyer edhe konfirmimi aty prej ministrisë, ndoshta është më mirë, drejtor, ose me anuluar ose me ndryshuar si vendim, me shkuar me ndryshim të vendimit, se tash për mjete të njëjta pavarësisht që janë bartje ose si po i quajmë tash, rritje, ndoshta na bien ndesh më vonë këto vendime, sepse ne e kemi konfirmimin për këto. Atëherë, a ka dikush tjeter?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrimit të kërkësës për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2023, bartjen në vitin 2024 dhe shpërndarjen e tyre, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend dhe gjithashtu të merret vendim për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-6135/2024 i miratuar me datë 23.02.2024 për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të vitit 2023 në vitin 2024 dhe shpërndarjen e tyre.**

**Pika 3. Shqyrtimi i propozim vendimit për rialokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale (Ref.drejt.fin).**

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, referoi drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, i cili kërkoi që kërkesa për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300), fondi burimor 10 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Brenda kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi 10, në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisë (660)**, nën-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional (0620)

- Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmire-Shtaricë” (kodi 54294), shuma **5,996.00 €**;
- Nga projekti “Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë në Klinë-Volljakë” (kodi 54334), shuma **7,495.00 €**;
- Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe” (kodi 54285), shuma **9,400.00 €**;
- Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës “Mal Bashota”, “Prek Prendi”, “Dositej Obradoviq”, “Bekim Fehmiu” dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dresnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **22,891.00 €**;
- Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike, Shpenzimet Kapitale (kodi 300), fondi burimor 21;
- Nga projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen “Arberia”, “Tigvesh”, te sheshi “Nënë Tereza”, Dollc-Dresnik, Grabanicë, Gremnik, Drenoc” (kodi 54332), shuma **4,497.00 €**;
- Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës “Mal Bashota”, “Prek Prendi”, “Dositej Obradoviq”, “Bekim Fehmiu” dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dresnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **4,497.00 €**.

**Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300), fondi burimor 22.**

- Nga projekti “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastruktura rrugore në Grykën e Jarinës - Pogradjë” (kodi 52443), shuma **15,276.50 €**;

- Nga projekti “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë” (kodi 52442), shuma **2,849.51 €**;
- Nga projekti “Ndërtimi i parkut industrial për Klinë” (kodi 52447), shuma **30,000.00 €**;
- Nga projekti “Ndërtimi me gurë i sheshit "Mujë Krasniqi" në Klinë “ (kodi 54004), shuma **1,250.80 €**;
- Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", "Dositej Obradoviq", "Bekim Fehmiu" dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dresnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **49,376.81 €**.
- **Arsyetim: Rialokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor, a ka dikush? Unë këtë te sheshi “Muji Krasniqi” këtu 1,250.00 euro i kisha heq, i kisha shtruar asfalt krejt. Po, Tunë?

**Tunë Deda:** Edhe unë i bashkëngjitëm propozimit të kryesuesit edhe kisha propozuar bile prej sheshit “Ndue Përleshë” deri te rruga e gjimnazit, bile atë pjesë me e bërë asfalt. Unë e kam thënë edhe përpara, ky projekt edhe pse ka qenë projekt i mirë, po projektuesi që e ka bërë këtë projekt e ka bërë keq.

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush? Kush është për?

**Asdren Ramadani:** Përshëndetje, kryesues, përshëndetje për gjithë! Desha rreth investimeve këtu te ”Malë Bashota”, mu duk që të dyjet ishin të zotuara, dmth njëra 49,000.00 euro, e tjetra 4 mijë e diçka. A është i njëjti projekt apo...?

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Po, i njëjti është.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Asdren. Dikush tjetër, a ka?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Atëherë, më lejoni ta përfundoj mbledhjen, duke ju falënderuar për pjesëmarrje dhe angazhim!

Procesmbajtësja,  
Monika Palushi



**KRYESUESI,**  
**Fadil Gashi**

